

Prezantime të Teatrit Shqiptar "Kurora" të Nionit

"Kurora" vazhdon rrugën e promovimit të kulturës shqiptare

Teatri "Kurora" i Nionit mund të merret si shembull i suksesit të mërgatës sonë në fushë të teatrit. Ky teatër ka disa vite që po zhvillon si aktivitet të suksesshëm promovimin e kulturës shqiptare e zvicerane. Në këtë vazhdimësi aktiviteteve "Kurora" do të paraqitet së shpejti para publikut me një pjesë të re teatrale, të titulluar "Letër Ngushëllimi"

Migjen Kajtazi

Në programe të ndryshme televizive shqiptare ka shumë prezantime lidhur me diasporën shqiptare në Zvicër. Këto emisione shpesh edhe pa dashje sikur na japin bindjen që komunitetit shqiptar si aktivitet kryesor argëtues ka diskut.

Lumturisht, ka shumë aktivitete të shoqatave dhe të individëve shqiptarë lidhur me dhe Për diasporën. Aktivitete që nuk shihen shpesh në TV-të shqiptare po që lënë gjurmë, jehonë e mesazh të madh te komuniteti shqiptar e zviceran. Kuptohet që këto aktivitete kërkojnë një organizim, koordinim, profesionalizim e sidomos kohë. Qëllimet dhe objektivat për njohjen dhe promovimin e kulturës shqiptare e bëjnë që e gjithë kjo punë e shoqatave dhe të individëve të gjejnë kënaqësi e mirënjohje të punës së tyre kur shohin rezultatet e kënaqshme.

Teatri "Kurora" i Nionit mund të merret si rast e shembull i suksesit. Ky teatër ka disa vite që po zhvillon si aktivitet të suksesshëm promovimin e kulturës shqiptare e zvicerane. Në këtë vazhdimësi aktiviteteve "Kurora" do të paraqitet së shpejti para publikut me një pjesë të re teatrale, të titulluar "Letër Ngushëllimi", të shkëputur nga vepra e publicistit të talentuar zviceran Lova Golotovtchiner, i cili është edhe një nga nismëtarët e themelimit të teatrit të njohur në Lozanë, atij të "Bulimisë".

Shfaqja është në gjuhën frënge, dhe është vënë në skenë nga regjisori i dëshmuar Visar Qusaj. Në rolet kryesore paraqiten aktorët Zymer Lutfiu e Samire Qusaj.

Kjo pjesë ka për temë një ngjarje të vendosur në kohën reale. Një çift përgatitet për të shkuar në varrim të një kolegu të bashkëshortit, i cili kishte vdekur papritmas gjatë shërbimit të punës. Gjatë përgatitjeve të shkrimit të letrës së ngushëllimit ndodhin replika dhe kundërthënie.

"Kurora", kandidat për çmimin federal të integritetit

Teatri "Kurora" ndërkohë po vazhdon me sukses shfaqjen e Driton Kajtazit "Zotri Guri Ura, i huajt nga këtu" që kësaj radhe paraqitet në teatrin e Echandole të Yverdonit të kantonit të Vaud më 28 dhe 29 nëntor.

Për më shumë të dhëna vizitoni faqen e internetit: <http://ccsi-yverdon.org/dotclear/pages/theatre.html> Kurora më këtë shfaqje është njëri nga kandidatët seriozë për të fituar çmimin e Integritetit për të Huajt në Zvicër të iniciuar nga Komisioni Federal për të Huajt.

THEATRE KURORA

présente



VENDREDI 19 OCTOBRE :

"LA LETTRE DE CONDOLÉANCE DE LOVA GOLOVCHINER",
PAR LE THÉÂTRE KURORA DE NYON - 20H00
-"ANONYM" - HIPHOP / SOUL - DÈS 22H00

SAMEDI 20 OCTOBRE :

"LA LETTRE DE CONDOLÉANCE DE LOVA GOLOVCHINER",
PAR LE THÉÂTRE KURORA DE NYON - 20H00
-"THE RASPUTINE SMOCKED BAND"
MUSIQUE BALKANIQUE TSGIGANE, DÈS 22H00



soutenu par le crédit de l'intégration de la
Confédération (ODE/CPE), et l'association
CSHCO

www.interculturel.ch
www.usinegaz.ch

Pllakati për shfaqjen më të re të "Kurorës"

Një dialog i mbushur me dashuri, me kundërthënie dhe kritika. Kjo vënie në skenë është menduar si formë e homazhit për femra por edhe për meshkuj që edhe pse me vështirësi në të kuptuar bëjnë që të fitojë ajo që lidhë më së shumti - Dashuria. Gjatë këtyre dy mbrëmjeve, pra më 19 e 20 tetor, teatri "Kurora" si bartës dhe përgjegjës i projektit për publikun ka ftuar grupin e mirënjohur të muzikës hiphop "Anonym" të udhëhequr nga këngëtari i mirënjohur Abdulla Mala që paraqitet me datën 19 tetor që nga ora 22 dhe grupin "The Rasputin Smoked Band" të njohur

me muzikën ballkanike. Ky i fundit paraqitet më 20 tetor nga ora 22.

Projekti është mbështetur nga Komisioni Federal për të Huajt dhe nga komuna e Nionit, ndërsa edhe Shoqata e Studentëve Shqiptarë të Universitetit të Lozanës (www.unil.ch/aeaul), shoqata e Komunitetit Shqiptar të Ballkanit "Shiko", kanë dhënë po ashtu ndihmën e tyre në organizim dhe në realizim që nga nisja e projektit.

Për më shumë informata të hollësishme: Visar Qusaj 079 359 65 17 në adresën elektronike kurora@hotmail.com ose në faqet www.usinegaz.ch dhe www.interculturel.ch



Nga një shfaqje e mëhershme